



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH**

Nr. 509/12 prot

Gramsh, më 22/03/2020

Vendim

Nr. 17, dt. 25.02.2020

Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh.

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjenca civile “Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh“, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, neni 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM nr. 453, dt.03.07.2019, “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti”, si dhe, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

Vendos:

- I. Të miratohen listat në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh si më poshtë:
 1. Familja e **z. Agim Shefqet Zogu** me përbërje familjare 4 vetë, struktura e apartamentit 1+1, kufiri maksimal i kredisë sipas përbërjes familjare, dhe nivelit të të ardhurave neto të jetë **2 580 000** lekë.
- II. Të miratohet Lidhja 3-Formati i listës emërore.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave civile.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc.E.Mema
Miratoi G.Lena
Dosja nr. _____
Afati _____



Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Endri MEMA

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA

**LIDHJA3 – Formati i listës emërore
BASHKIA GRAMISH**

Nr. Rendor	Emri/Atësia/Mbiemri	Përberja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, germa (a))	Kushtet familjare (neni 16, germa (b))	Kushtet sociale (neni 16, germa (c))	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Vlera maksimale e apartamentit që përfiton
1	2	3	4	5	6	7	8	9	9
19	Agim Shefqet Zogu	4	1+1	Nuk ka banese	Nuk ka	Nuk ka	42 923	Në shtet	2580000

Konc. E. Mema

Miratoj G. Lena

Dosja nr. _____

Afati _____

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Endri MEMA

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Greta LENA

